



KOMUNA KLINË  
Zyra për Punë të Kuvendit  
01Nr. 06- 3022 /17  
Klinë, më 18. 04. 2017

### EKSTRAKT-PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IV-te e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur me datën 18. 04. 2017, në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim në orën 10:00.

#### R e n d i i d i t ë s :

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i propozimit për vënie në Diskutim Publik të Draft-strategjisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Klinës 2017-2021,
4. Shqyrtimi i Raportit të Ekzekutivit për periudhën janar-dhjetor 2016,
5. Shqyrtimi i Planit të shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve të rrezikuar nga qentë endacakë dhe siguria nga automjetet,
6. Shqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës lidhur me Planin e menaxhimit të mbeturinave (Plotësim i preambulës me nenin 10 të Ligjit për Mbeturina o4/060) sipas kërkesës së MMPH-së,
7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura KPF-së për muajin mars 2017,
8. Të ndryshme.

Prezent në mbledhje ishin:

1. Dr. Haxhi Ibishi..... Kryesues
2. Halil Desku..... anëtar
3. Ramush Agushi..... anëtar
4. Pal Berisha ..... anëtar
5. Skender Merturi ..... anëtar
6. Ndue Shabanaj..... anëtar
7. Fadil Gashi..... anëtar

Pjesëmarrës të tjera në mbledhje ishin: Përfaqësues të OSBE-se, të KFOR-it, të Zyrës Ligjore të Komunës, drejtori i Drejtorisë për Ekonomi e Financa, z. Ramiz Rrustaj, drejtori Drejtorisë së Arsimit z. Hajdin Morina, drejtori i Drejtorisë së Gjeodezisë, z. Zeqir Morina e tjë.

Mbledhjen e hapi z. Haxhi Ibishi- kryesues, i cili pasi i përshëndeti të pranishmit kerkoi një minutë heshtje për vdekjen e Dulaman Gashit, i cili për tri mandate me radhë ka qenë anëtar i Kuvendit të Komunës, dhe pas kësaj ai i lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në këtë mbledhje dhe shtoi se kemi një kërkesë nga Drejtoria e Financave për rialokimin e mjeteve e mjeteve të buxhetuara për të gjitha programet në vlerë prej 18.450.00 të këruara urgjentisht nga Ministria e Financave. “A pajtoheni që të përfshihet kjo kërkesë në pikën e te futët në rend të rendit të ditës si pikë e veçantë ?”- shtoi Kryesuesi.

Të gjithë anëtaret e KPF-se u pajtuan me këtë propozim..

Rendi i paraparë i ditës u miratua unanimisht nga të pranishmit.

**Pika e I-rë: Arsyetimi i mungesave**

Dr. Haxhi Ibishi tha së të gjithë anëtaret e KPF-se janë prezent në mbledhje.

Pika e II-te: Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar.

Me gjashtë vota pro dhe një abstenim procesi i mbledhjes së kaluar u miratua.

**Pika e III-të: Shqyrtimi i propozimit për vënie në Diskutim Publik të Draft-strategjisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Klinës 2017-2021.**

**Dr. Haxhi Ibishi**, pyeti se a pajtoheni që t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të këtij propozimi?

KPF i rekomandon Kuvendit që ta shqyrtojë dhe ta miratojë këtë propozim.

**Pika e IV-te: Shqyrtimi i i raportit të Ekzekutivit për prridhen janar – dhjetor 2016**

**Dr. Haxhi Ibishi**, propozoi që Komiteti t'i rekomandojë Kuvendit që ta shqyrtojë dhe miratojë këtë raport.

KPF i rekomandon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e radhës ta shqyrtoi dhe miratoi këtë raport.

**Pika e V-te: Shqyrtimi i planit të shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve të rrezikuar nga qentë endacakë dhe siguria nga automjetet.**

**Dr. Haxhi Ibishi** tha së ne në vazhdimësi kemi pasur kërkesa për shpenzime të udhëtimeve por për këtë plan të shpenzimeve të bërë nga drejtoria e arsimit fjalën ja japi drejtorit të drejtorisë se Arsimit z. Hajdin Morina.

**Hajdin Morina**, tha se është bërë një plan i shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve të rrezikuar nga qentë endacakë dhe siguria nga automjetet për nxënësit e shkollave fillore prej klasës së parë e deri në klasën e nëntë për nxënësit që udhëtojnë në me shumë së dy km. “Lidhur me këtë i kemi njoftuar të gjithë drejtorët e shkollave fillore që ta bëjnë këtë planifikim dhe kemi premtuar së do i mbulojmë 30% të

pagesës së shpenzimeve të udhëtimeve, por ky planifikim do të shqyrtohet edhe në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

**Pal Berisha**, tha së unë prita nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit së çfarë veprimesh do të ndërmarr Komuna që kjo çështje të zgjidhet.

**Halil Desku**, tha këto mjete financiare nuk janë planifikuar në buxhet andaj mendoi së me rishikimin e buxhetit të parashihen këto mjete për ta realizuar këtë plan.

**Ndue Shabanaj**, tha se unë e përshëndes punën e Drejtorisë së Arsimit, sepse kemi një rrezikshmëri, por ky plan ka edhe kosto financiare por ja vlen që të ndahen mjete buxhetore për të realizuar siguri për nxënësit tanë. “Çështja e rregullativës Ligjore sipas kilometrave të përcaktuar me Ligj duhet të zbatohet dhe është mirë që kemi një pasqyrë të përgjithshme të kategorisë së nxënësve të rrezikuar”, theksoi prof. Shabanaj.

**Dr. Haxhi Ibishi**, pyeti se a pajtoheni që t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të këtij plani?

KPF rekomandon kjo pikë e rendit të ditës të bartet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

**Pika e VI-te: Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës për Planin e Menaxhimit të Mbeturinave (plotësim i preambulës me nenin 10 të Ligjit për mbeturina, nr. 04/060) sipas kërkesës së MMPH).**

**Dr. Haxhi Ibishi** tha së Vendimi na kthehet nga Ministria e mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për arsy se nuk është shkruar preambula sipas Ligjit dhe nëse pajtoheni që t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

KPF i rekomandon Kuvendit të Komunës që të shqyrtohen plotësimet e këtij Vendimi.

#### **Pika e VII-te: Shqyrtimi i kërkesave të arritura**

1. Kërkesa e banorëve të fshatrave Rigjevë dhe Stapanicë kërkojnë nga Komuna që t'u jepet prona për varreza.

**Ali Shala**, tha se kemi pasur edhe me parë kërkesa të tillë por kjo kërkesë është e pa kompletuar, kjo kërkesë duhet të shqyrtohet së bashku nga drejtoria e Urbanizmit dhe ajo e Kadastrës, këtu kërkohen katër ngastra që janë kulturë bujqësore dhe thuhet prona shoqërore, e termi pronë shoqërore me nuk ekziston por pronë Komunale. “Kërkesës është dashur t'i bashkëngjitet edhe një plan ideor dhe të shkoi përmes BIK-ut në Prishtinë”, theksoi zyrtari Shala.

**Ramush Agushi**, tha se ne nuk duhet të ngutemi dhe se e përkrahu propozimin e Ali Shalës.

**Skender Merturi**, tha se unë mendoj që është mirë që Zyra Ligjore e Komunës t'ua kthej një përgjigje me shkrim dhe t'i udhëzojë ata se si mund ta fitojnë këtë të drejtë.

**KPF - rekomanon që kërkesa duhet të kompletohet.**

Banorët e fshatit Zajm, kërkojnë nga Komuna rregullimin e trotuarit dhe rregullimin e ujërave të zeza.

NT "Semirra", kërkon nga Komuna rregullimin e infrastrukturës; si trotuar, ujë, ndriçim sepse kemi shumë biznese që janë hapur në këtë pjesë pra afër udhëkryqit Prishtinë-Pejë.

**Komiteti për Politikë dhe Financa për këto dy kërkesa rekomanon që t'i barten për shqyrtim drejtorisë Komunale të Urbanizmit.**

**Pika e VIII-te: Rialokimi i mjeteve të buxhetuara.**

**Ramiz Rrustaj**, tha së është i domosdoshëm transferi- rialokimi i mjeteve të buxhetuara për të gjitha programet në vlerë prej 18.450.00, këto mjete janë të koduara por me ndryshimet e bëra këtë vit nga Ministria e Financave nuk mund të shfrytëzohen andaj duhet të rialokohen në kode të tjera.

**KPF rekomanon që kjo kërkesë të bartet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika e IX-te Të ndryshme.**

**Fadil Gashi**, tha se është e udhës që Kuvendi ta mbajë një mbledhje komemorative për Dulaman Gashin, i cili ka qenë tri mandate radhazi anëtar i Kuvendit.

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha se pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe do ta njoftojë edhe Kryetarin e Komunës.

Anëtaret e Komitetit për Politikë dhe Financa njëzetit u pajtuan që në orën 15:00 në sallën e Kuvendit të Komunës të mbahet mbledhje komemorative, do të njoftohet familja e tij, miqtë dhe të gjithë anëtaret e Kuvendit.

Me kaq mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa përfundoi punën në orën 10:50.

Procesmbajtësi,  
Beqir Gashi

